



Mbreme me ndeshjen Portugali - Islande janë mbyllur edhe ndeshjet e para në grupe të vlefshme për Euro 2016. Në këto ndeshje vëhet re numri i ulët i golave të shënuara ku në asnjë nga ndeshjet nuk janë shënuar më shumë se sa 3 gola. Asnjë nga ekipet nuk ka shënuar më shumë se sa 2 gola. Në total janë shënuar 22 gola dhe shumica e golave janë shënuar në pjesët e dyta, të cilët janë plot 16.

Ekipi i Zivres ka përqindjen më të lartë të pasimeve të sakta me 92% (510/553), kurse Shqipëria zë vendin e pestë me 88% (365/414) mbas Portugalisë, Gjermanisë dhe Spanjës. Portieri Etrit Berisha renditet në vendin e tretë për numrin më të lartë të shpëtimit nga shënimi i golit me plot 6 raste, kurse vendin e parë e mban Halldorsson i Islandes me 10 të tilla.